

# Udhëzuesi për mediet sociale #FundOurSchools

Rrethi Shkollor i Filadelfias ka hartuar këtë udhëzues për të ndihmuar në lehtësimin e ndikimit kritik financiar që do të ketë pandemia "COVID-19" në buxhetin e Rrethit Shkollor të Filadelfias. Në këtë udhëzues do të gjeni informacione dhe mesazhe të sugjeruara nga fushata jonë "Fund Our Schools", të cilat kanë për qëllim t'ju japin udhëzime dhe një panoramë të përgjithshme lidhur me komunikimin me zyrtarët e zgjedhur dhe me palët e jashtme të interesit.

## Ky udhëzues përmban mesazhe dhe grafikë:

- Për të ndihmuar që senatorit Toomey dhe senatorit Casey t'iu komunikohet nevoja urgjente për miratimin e ligjit "HEROES" nga Senati Amerikan.
- Për të ndihmuar në amplifikimin e zërit tuaj. Si banor ose banore e Pensilvanisë, zëri juaj ka rëndësi.
- Për të ndihmuar në angazhimin e politikëbërësve në diskutimin e çështjeve me të cilat përballen zgjedhësit, si ju, në komunitetet tuaja.
- Për të ndihmuar në përcjelljen e mesazheve aktuale dhe të sakta nga një burim i besueshëm.
- Për të ndihmuar në bashkëndarjen e burimeve.

Të gjithë grafikët dhe mesazhet e sugjeruara janë të disponueshëm për përdorim në profilet në mediet sociale dhe në faqet e internetit.

Për më shumë imazhe dhe përmbajtje lidhur me hashtagun #FundOurSchools, mund të vizitoni faqen tonë të internetit në: [philasd.org/fundourschools](http://philasd.org/fundourschools).

Ju lutem, mos harroni të përdorni hashtagun #FundOurSchools sa herë që postoni ndonjë përmbajtje që ka të bëjë me fushatën "Fund Our Schools".

## Hashtagu:

#FundOurSchools

## Taktikat:

- Përdorni grafikët e thjeshtë për të krijuar një atmosferë komunitare
- Përdorini mediet sociale si hapësirë për të ndërtuar bashkëpunim dhe krijuar urgjencë
- Bëjuni "TAG" zyrtarëve tuaj të zgjedhur në postimet tuaja.  
Për të gjetur emrat dhe të dhënat e kontaktit të përfaqësuesve tuaj, vizitoni faqen: <https://live.cicerodata.com/>


## Shembuj të mesazheve në mediet sociale

- ✓ Filadelfia ka nevojë që Senati Amerikan të miratojë ligjin "HEROES" & #FundOurSchools @SenToomey & @SenBobCasey
- ✓ Ligji "HEROES" përfshin financime thelbësore për t'i mbajtur nxënësit dhe personelin të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim. @SenToomey & @SenBobCasey miratojeni këtë ligj dhe #FundOurSchools
- ✓ @SenToomey & @SenBobCasey shkollat në Filadelfia janë goditur rëndë nga COVID-19-a. Ndihmojini nxënësit dhe personelin të jenë të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim. Miratoni tani ligjin "HEROES" #FundOurSchools
- ✓ Rrethëve shkollorë u duhet financimi federal për të mbyllur hendeqet buxhetore dhe për të respektuar kërkesat shëndetësore & të sigurisë. Kemi nevojë që @SenToomey & @SenBobCasey të veprojnë tani dhe të miratojnë ligjin "HEROES". #FundOurSchools
- ✓ Ligji "HEROES" përfshin më shumë sesa 450 milionë dollarë për nxënësit dhe shkollat e Filadelfias. Kemi nevojë për këto fonde për të parandaluar shkurtimet buxhetore dhe për t'i mbajtur nxënësit dhe personelin të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim. Fëmijët e Filadelfias duan që @SenToomey dhe @SenBobCasey të #FundOurSchools
- ✓ @SenToomey dhe @SenBobCasey DYK: Buxheti i @PHLSchools është goditur rëndë nga COVID-19-a. Kemi nevojë që ju të miratoni ligjin "HEROES" për të ofruar financimin e shumëkërkuar për të mbajtur nxënësit & stafin të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim #FundOurSchools

## Grafikët për mediet sociale

Të gjithë grafikët janë të disponueshëm për t'u përdorur në profile në mediet sociale dhe në faqet e internetit.

Ju lutem, mos harroni të përdorni hashtagun #FundOurSchools sa herë që postoni ndonjë përmbajtje që ka të bëjë me fushatën "Fund Our Schools".



Shkarkoni grafikët për mediet sociale

## Shfaqni përkrahjen tuaj

si kampion i hashtagut #FundOurSchools në Facebook. Kornizën mund ta gjeni duke kërkuar hashtagun #FundOurSchools kur përzgjidhni kornizën për profilin e ri.

